



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labiriot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 06.08.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-684/2
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin Nr. 400/01-35167 për bartjen e mjeteve financiare nga rezerva buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.



026/120 1157-1/2021
04/08/2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Per:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Trim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Kryetari i Komunës së Drenasit
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtues i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
I. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vesa Janova, Zyrtarë e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
I. ënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit
I. loji i aktit:	Vendim

Inderuari Ministër z. Krasniqi,

Inderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 400/01-35167 dt. 30.07.2021 për bartjen e mjeteve financiare nga rezerva buxhetore për projektin digjitalizimit shkollave

I miratuar më datë 30.07.2021

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.07.2021

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.08.2021

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës së Drenasit, vlerëson që akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë.

Rregullorja (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në përmbajtje të Shtojcës II thekson aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë. Në këtë drejtim, në pikën 37 të kësaj shtojce parashihen vendimet për ndarjet dhe rindarjet buxhetore sipas ligjit për buxhet vjetor, si akte të komunave që nuk i nënshtrohen konfirmimit të ligjshmërisë.

Ndarja buxhetore, në Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, përkufizohet si në vijim:

“...shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizatë buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi ose për bartje nga një organizatë buxhetore të një autoritet publik ose ndërmarrje publike në formë të grantit.”

Kriteret që dalin nga ky përkufizim, e që janë relevante në shqyrtimin e rastit konkret, janë shuma e ndarë nga një organizatë buxhetore për shpenzim në një program ose kategori tjetër shpenzimi. Lidhur me këtë, në përmbajtje të vendimit të komunës së Drenasit përcaktohet një shumë financiare për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike e rezervave në kategorinë ekonomike projekte kapitale.

Në këtë drejtim, meqenëse vendimi i komunës së Drenasit i plotëson kriteret e përkufizimit të ndarjes buxhetore, si dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve vlerëson se akti i kësaj komune nuk i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr 400/01- 35167 dt. 30.07 2021

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjes Lokale, nenit 34,pika 34.6,të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe në bazë të rekomdanimit të Drejtorisë së Arsimit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë **30.07.2021**, të miratoi këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve financiare nga rezerva buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave

Neni 1

Më këtë vendim kërkohet bartja e mjeteve financiare nga rezerva buxhetore për projektin "Digjitalizimi i Institucioneve arsimore në Drenas".

Neni 2

Shuma financiare për digjitalizimin e Institucioneve arsimore është prej 60,000.00 €, e cila shumë financiare është paraparë me buxhetin e vitit kalendarik 2021.

Neni 3

Financimi do të bëhet nga Buxheti i Drejtorisë së Arsimit nga kategoria ekonomike: Projekte Kapitale, kodi ekonomik: 611920-2137696.

Neni 4

Kjo shumë financiare ju ndahet të gjithave Institucioneve arsimore në Komunën e Drenasit me qëllim të digjitalizimit të tyre.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj

Arsyetimi

Shuma financiare prej : 60,000.00 € ka për qëllim digjitalizimin e të gjitha shkollave duke përfshirë platformën për digjitalizim dhe infrastrukturën fizike (rrjetin e brendshëm të internetit në shkolla).

Gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2021 ky projekt veç ka marrë miratimin e Kuvendit të Komunës në kuadër të projekteve kapitale, mirëpo si projekt i ri edhe pas vlerësimit në bazë të Udhëzimit administrativ Nr. 06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale nga Ministria e Financave është vendosur në rezervën buxhetore.

Prandaj më qëllim që të zhvillohet si projekt këtë vit kërkohet aprovimi nga Kuvendi i Komunës në Drenas.

Digjitalizimi është nevojë e kohës dhe kontribon në përmasimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësim nxënie duke mundësuar marrjen e të gjitha informatave në kohën reale.